



**Përgj.:** Data përfundimtare fikse për përfshirje në Listën e votuesve të këtij viti është 12 tetori. Në listë do të përfshihet çdokush që kryen regjistrimin civil deri më këtë datë dhe në Ditën e Zgjedhjeve ka apo do të ketë 18 vjet.

**Pyetja:** *Si/ku mund ta kontrolloj, nëse jam i regjistruar si votues?*

**Përgj.:** Duke shkuar në zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve ose duke shikuar faqen zyrtare të internetit të KQZ-së ([www.cec-ko.org](http://www.cec-ko.org)).

**Pyetja:** *Çka nëse nuk e gjej emrin tim në Listën e votuesve, por besoj se unë është dashur të isha i përfshirë?*

**Përgj.:** Nëse jeni votues me të drejtë vote, por nuk e gjeni emrin tuaj në Listën e votuesve, mund të dorëzoni parashtresë në Komisionin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa. Formularët për parashtresa të këtij Komisioni do të gjenden në të gjitha Komisionet Komunale të Zgjedhjeve. Nëse është e mundur, parashtresës tuaj ia bashkangjitni edhe dëshminë e regjistrimit tuaj civil.

**Pyetja:** *Si caktohet lokacioni i votimit?*

**Përgj.:** Lokacioni i votimit (lokacioni i qendrës së vendbanimit të votuesit, siç është e shënuar në regjistrin civil.

**Pyetja:** *Ku të votoj në Ditën e Zgjedhjeve?*

**Përgj.:** Në qendrën e votimit që përkon me P-kodin e adresës së vendbanimit të votuesit ( siç është e shënuar në regjistrin civil) ose në qendrën e votimit që i është caktuar votuesit gjatë periudhës së Shërbimit të Votuesve të vitit 2004.

**Pyetja:** *Ku të azhurnohen të dhënat e votuesve?*

**Përgj.:** Çdo azhurnim i të dhënave të votuesve duhet të bëhet nëpërmes regjistrin civil.

**Pyetja:** *Si/ku mund t'i kontrolloj të dhënat e mia të votuesit?*

**Përgj.:** Duke shkuar në zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve për të dhënat e plota, ose duke shikuar faqen zyrtare të internetit të KQZ-së

për të dhënat për lokacionin e votimit ([www.cec-ko.org](http://www.cec-ko.org)).

**Pyetja:** *Çka do të bëhet nëse nuk pajtohem me lokacionin e votimit i cili më është caktuar?*


**Përgj.:** Procesi i caktimit të votuesve nëpër qendrat e votimit është automatik dhe bazohet në të dhënat e regjistruara në regjistrin civil. Votuesit mund t'i ndryshojnë këto dhënat vetëm duke shkuar në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil. Mirëpo, nëse votuesi nuk pajtohet me procesin e caktimit në qendrën e votimit ose beson se është shkelur ndonjë rregull apo rregullore e zgjedhjeve, ai ose ajo mund të parashtrojë ankesë në Komisionin e Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP). Formularët për ankesa mund t'i gjeni në të gjitha Komisionet Komunale të Zgjedhjeve .

**Pyetja:** *Çka mund të bëhet nëse votuesi nuk pajtohet me lokacionin e qendrës së votimit që i është caktuar për arsye siç janë: liria e lëvizjes, largësia e qendrës së votimit, gabimi evident në bazën e të dhënave, ose ndarja parasheh më shumë se sa një mundësi të qendrës së votimit?*

**Përgjigj.:** Zyrtari i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve do të plotësojë formularin e verifikimit të të dhënave sipas vlerësimit të vet, dhe aty do të shënohen të dhënat e votuesit, arsyeja për kundërshtimin e qendrës së caktuar për votim, detajet e qendrës së re të votimit të propozuar dhe rekomandimin e zyrtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve për veprim (nëse konsiderohet i nevojshëm). Pastaj formulari do të dërgohet për shqyrtim dhe vendim nga Sekretariati i KQZ-së dhe Departamenti i Zgjedhjeve i OSBE-së. Pastaj votuesi do të njoftohet për rezultatet e atij verifikimi.

Kontrolloni faqen e internetit të KQZ-së së Kosovës, në mënyrë që të kuptoni se çka ju duhet për periudhën e regjistrimit të votuesve, si dhe për çdo gjë tjetër që votuesi duhet të dijë në lidhje me zgjedhjet e sivjetme.

Të gjithë qytetarët e regjistruar me të drejtë vote do të mund të gjejnë detajet e lokacionit të tyre të votimit në faqen e internetit të KQZ-së, e që është ([www.cec-ko.org](http://www.cec-ko.org))





Periudha e Shërbimit  
të Votuesve: 27 shtator – 12 tetor

ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE KOMUNALE TË KOSOVËS 2007

**2007**

PËR ÇDO ÇËSHJE TË JETËR NË LIDHJE ME SHËRBIMIN E VOTUESVE PËR ZGJEDHJET E SIVJETME PARLAMENTARE DHE KOMUNALE TË KOSOVËS. TË CILAT DO TË MBAHEN MË 17 NËNTOR. VIZITONI KOMISIONIN KOMUNAL TË ZGJEDHJEVE NË KOMUNËN TUAJ PREJ 27 SHTATOR DERI MË 12 TETOR. GJITHASHTU MUND TË SHIKONI FAQEN E INTERNETIT TË KQZ-SË. [WWW.CEC-KO.ORG](http://WWW.CEC-KO.ORG)



Objektivi i programit të informimit të votuesve në vitin 2007 është t'u sigurojë votuesve lloje të përgjithshme të informatave në vijim:

- Kush ka të drejtë vote?
- Ku të votojnë?
- Si/ku të azhurnojnë të dhënat e votuesve?

Të gjithë qytetarët me të drejtë vote në Kosovë duhet të dinë se kushtet themelore të cilat duhet t'i përmbushin në mënyrë që të votojnë, janë:

- Të jenë 18 vjeçar para ose në ditën e zgjedhjeve.

#### **DHE**

- Të jenë të regjistruar në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në komunën e tyre.

Nëse tanimë keni kryer regjistrimin civil, ju vetëm duhet të:

- Shkoni në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve për të kuptuar se ku gjendet qendra juaj e votimit.

Ju vetëm duhet të shkoni dhe të votoni më 17 nëntor, nëse:

- Tanimë e keni kryer regjistrimin civil, e dini se ku gjendet qendra juaj e votimit dhe që nga zgjedhjet e kaluara nuk ka ndryshuar asgjë në të dhënat tuaja si votues, siç janë adresa juaj në Kosovë ose emri juaj.

Disa votues duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme të dhënave të regjistrimit. A jeni ju njëri nga këta votues? Parashtroni vetes pyetjet e mëposhtme:

- A jam unë i saporegjistruar në Regjistrin Civil?
- A e kam kryer unë regjistrimin civil dhe a i kam ndryshuar të dhënat e adresës së vendbanimit tim që nga zgjedhjet e vitit 2004?
- A e kam kryer unë regjistrimin civil dhe a i kam mbushur 18 vjet që nga zgjedhjet e mëparshme ose a do t'i mbush 18 vjet deri në Ditën e Zgjedhjeve të vitit 2007?

Në qoftë se përgjigja juaj në cilëndo prej këtyre pyetjeve është "PO", atëherë duhet të dini se ekzistojnë disa mënyra se si mund të informoheni se çka duhet të bëni ju që të mund të votoni këtë vit:

- Do të merrni njoftimin përmes postës.

- Mund të regjistrohemi dhe t'ju caktohet qendra e votimit juve personalisht në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në komunën tuaj.
- Mund të shkoni personalisht në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj që të merrni çfarëdo informate që ju duhet në lidhje me regjistrimin e votuesve.
- Mund ta shikoni faqen zyrtare të internetit të KQZ-së: [www.cec-ko.org](http://www.cec-ko.org)

#### Kush do të marrë njoftim përmes postës?

- Të gjithë të saporegjistruarit.
- Ata që kanë kryer regjistrimin civil, që e kanë lajmëruar Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil se i kanë ndryshuar të dhënat e adresës së vendbanimit të tyre që nga zgjedhjet e vitit 2004.
- Ata që kanë kryer regjistrimin civil, që kanë mbushur 18 vjet që nga zgjedhjet e kaluara ose që do t'i mbushin 18 vjet deri në Ditën e Zgjedhjeve të vitit 2007.

A jeni ju njëri nga këta? Nëse po, atëherë duhet ta dini se letrat do të jenë të personalizuar (d.m.th. do t'i drejtohen votuesit të caktuar) dhe aty do të thuhet:

*Me anë të kësaj letre ju informojmë se ju është caktuar qendra e votimit ku mund të votoni në Ditën e Zgjedhjeve në përputhje me të dhëna e adresës suaj në regjistrin civil. Nëse mendoni se të dhënat janë të pasakta, luteni të shkoni në zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj prej 27 shtatorit 2007.*

*Adresa juaj: SHËNONI {ADRESËN E TANISHME, P-KODIN, FSHATIN/QYTETIN, KOMUNËN}.*

*Qendra juaj e votimit: SHËNONI {EMRIN E QENDRËS SË VOTIMIT, NUMRIN E QENDRËS SË VOTIMIT}*

#### Kush mund të informohet personalisht në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil?

- Të saporegjistruarit (që sapo kanë kryer regjistrimin civil).
- Të regjistruarit që shkojnë në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil për t'i ndryshuar të dhënat e adresës së vendbanimit të tyre (të moshës mbi 18 vjeç).

#### Çfarë lloj informatash mund të merrni në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil:

- Një kopje të materialit në letër, në të cilin qendra përkatëse e votimit është e rrumbullakësuar.
- Aty do të jetë poster i me listën e qendrave të votimit të ndara në bazë të p-kodeve. Nëpunësi i Qendrës Komunale të Regjistrimit Civil do t'ju ndihmojë të gjeni lokacionin e qendrës suaj të votimit, në bazë të p-kodit të adresës së vendbanimit tuaj, ashtu siç është i shënuar në Regjistrin Civil.
- Nëse ju nevojiten qartësime të mëtutjeshme në lidhje me lokacionin e qendrës së votimit, Qendra Komunale e Regjistrimit Civil do t'ju drejtojë tek Komisioni Komunal i Zgjedhjeve.

#### Shkoni në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve nëse keni diçka të paqartë në lidhje me procesin e regjistrimit të votuesve

#### Ja si mund t'ju ndihmojë zyrtari i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve :

- Pajis të gjithë votuesit e regjistruar me të drejtë vote me të dhënat e tyre përkatëse të votuesve.
- Plotëson formularin e verifikimit të të dhënave, nëse votuesi ka ndonjë vërejtje sa i përket ndarjes së qendrës së tij/saj të votimit, për arsye të ndryshme, siç janë: liria e lëvizjes, largësia nga qendra e votimit, gabimi evident në bazën e të dhënave, apo kur ndarja jep më shumë se sa një mundësi të qendrës së votimit, etj.
- U përgjigjet pyetjeve tuaja më të shpeshta.
- U mundëson votuesve të paraqesin parashtrësia apo ankesa në lidhje me Shërbimin e Votuesve.

Lexoni pyetjet e mëposhtme që shtrohen më së shpeshti nga njerëzit lidhur me procesin e regjistrimit. Ju mund të keni një pyetje të ngjashme dhe ju duhet të dini përgjigjen.

*Pyetja: Kush ka të drejtë vote?*

*Përgj.: Kushdo që kryen regjistrimin civil dhe ka të paktën 18 vjet në Ditën e Zgjedhjeve.*

*Pyetja: Deri kur mund ta kryeni regjistrimin civil për t'u përfshirë në Listën e votuesve të këtij viti?*